



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 803 Prot.

Tiranë, më datë 08.06 2021

VENDIM
Nr. 274, datë 08.06.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e konceptit të *Gërmimit Arkeologjik, Faza 1 dhe 2, si dhe Sondazhi arkeologjik, në Zonat me Nr. Pasurie 6/44, 6/53, 6/58, 6/76, 6/83, 6/111 (jashtë rrethim të Mozaikut), Nr. 6/381, 6/52, 6/55 (brenda rrethimit të Mozaikut), Zona Kadastrale Nr. 8210, Mozaiku i Tiranës*, aplikues Anisa Bejko dhe zhvillues Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë;
2. Gërmimi arkeologjik dhe Sondazhi arkeologjik të realizohen nga IKTK në bashkëpunim me DRTK Tiranë, sipas konceptit të miratuar;
3. Rezultati i Gërmimit arkeologjik dhe Sondazhit arkeologjik, të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

